



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 25 nëntor 2021
Nr.ref.:RK 1903/21

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI149/21

Parashtrues

Nehat Publica

**Vlerësim i kushtetutshmërisë
së Njoftimit A. S. Su. A. 184/21 të Gjykatës Supreme të Kosovës
të 5 gushtit 2021**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhami Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Nehat Publica nga Obiliqi (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kérkesës konteston njoftimin e Gjykatës Supreme të Kosovës (A. S. Su. A. 184/21) të 5 gushtit 2021.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së njoftimit të kontestuar përmes të cilit parashtruesit të kérkesës, sipas pretendimeve të tij, i janë shkelur të drejtat e garantuara me nenin 3 [Barazia para Ligjit], nenin 21 [Parimet e Përgjithshme], nenin 23 [Dinjiteti i Njeriut], nenin 24 [Barazia para Ligjit], nenin 27 [Ndalimi i Torturës, Trajtimi Mizor, Çnjerëzor ose Poshtërues], nenin 29 [E Drejta e Lirisë dhe Sigurisë], nenin 30 [Të Drejtat e të Akuzuarit], nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 36 [E Drejta e Privatësisë], nenin 37 [E Drejta e Martesës dhe Familjes], nenin 38 [Liria e Besimit, e Ndërgjegjes dhe e Fesë] dhe nenin 40 [Liria e Shprehjes] të Kushtetutës e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta).
4. Parashtruesi i kérkesës kërkon nga Gjykata që identiteti i tij të mos zbulohet publikisht.

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrin 7 të nenit 113 [Juridiksiioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, nenin 22 [Procedimi i kérkesës] dhe nenin 47 [Kérkesa individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe rregullin 32 [Parashtrimi i kérkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

6. Më 19 gusht 2021, parashtruesi i kérkesës përmes postës ka dorëzuar kérkesën në Gjykatë.
7. Më 1 shtator 2021, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Radomir Laban Gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtyues, të përbërë nga gjyqtarët: Safet Hoxha (kryesues), Remziye Istrefi-Peci dhe Nexhami Rexhepi.
8. Më 24 shtator 2021, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kérkesës.
9. Më 18 tetor 2021, Gjykata e njoftoi Gjykatën Supreme të Kosovës për regjistrimin e kérkesës dhe ia dërgoi të njëjtës një kopje të kérkesës.
10. Më 10 nëntor 2021, Kolegji shqyrtyues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kérkesës.

Përbledhja e fakteve

11. Parashtruesi i bashkëngjit kërkesës dokumentet nga dy procedura në të cilat është i përfshirë parashtruesi, përkatësisht; 1) Procedura penale kundër parashtruesit të kërkesës dhe 2) Procedura disiplinore e iniciuar nga parashtruesi i kërkesës kundër ushtruesit të detyrës së prokurorit në rastin e tij. Prandaj, gjykata do të paraqesë përbledhje të veçantë të fakteve pér këto dy procedura.

Përbledhja e fakteve lidhur me procedurën penale kundër parashtruesit të kërkesës

12. Më 28 gusht 2020, Policia e Kosovës parashtroi kallëzim penal me numër 2020-BC-726 kundër parashtruesit të kërkesës, sepse ekzistonte dyshimi i arsyeshëm se më 13 korrik 2020 dhe deri më 24 gusht 2020, i dyshuar (parashtruesi i kërkesës) i ka dërguar mesazhe të ndryshme bashkëshortes së tij në të cilat e ka kërcënuar dhe me atë veprim ka kryer veprën penale "Kanosja" nga neni 181 paragrafi 4 i KPRK-së dhe "Dhuna në familje" nga neni 248 paragrafi 1 i KPRK-së.
13. Më 21 shtator 2020, Prokuroria Themelore në Mitrovicë ngriti aktakuzën nr. PP/II. 1197/20 kundër parashtruesit të kërkesës, pér shkak të dyshimit të bazuar se ka kryer veprën penale Ngacmimi nga neni 182 paragrafi 2, në lidhje me paragrin 1 të KPRK-së;

"... në disa raste, në muajin e fundit gati pér çdo ditë e deri më 21.08.2020 në Mitrovicë, në mënyrë të vazhdueshme dhe të padëshirueshme e ka tërheqjen vëmendjen kah vetja dhe me këtë rast e ka sjell të dëmtuarën M. H. në gjendje të vuajtjes së rëndë shpirtërore, në atë mënyrë që çdo ditë i ka dërguar SMS porosi të dëmtuara, si edhe anëtarëve të familjes sëe saj, edhe pse e dëmtuara - bashkëshortja e tij e ka braktisur dhe është kthyer te prindërit."
14. Më 11 nëntor 2020, parashtruesi i kërkesës parashtroi kundërshtim në Gjykatën Themelore në Mitrovicë (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Themelore) lidhur me provat dhe kërkesë pér hedhjen poshtë të aktakuzës.
15. Më 6 janar 2021, Gjykata Themelore me Aktvendimin (P. nr. 644/20), refuzoi si të pabazuar kundërshtimin e provave dhe kërkesën pér hedhjen e aktakuzës (PP. II. nr. 1197/2020), e cila ishte parashtruar kundër parashtruesit të kërkesës. Me të njëtin aktvendim, Gjykata Themelore refuzoi si të pabazuar edhe kërkesën pér shpalljen e kësaj gjykate si jokompetente në pikëpamje territoriale.
16. Në një datë të pacaktuar, parashtruesi i kërkesës parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit kundër aktvendimit (P. nr. 664/20) të Gjykatës Themelore, të 6 janarit 2021 pér shkak të, "shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljes së ligjit penal dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike".

17. Më 8 mars 2021, Gjykata e Apelit, me aktvendimin (PN. nr. 181/2021), e refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe vërtetoi në tërësi aktgjykimin e Gjykatës Themelore.
18. Në një datë të pacaktuar, parashtruesi i kërkesës dorëzoi te Kryetari Gjykatës Supreme kundër vendimit (PN. nr. 181/2021) të 8 marsit 2021 “kërkesë për interpretimin ligjor të vendimeve të gjykatës themelore dhe të apelit”, si dhe ankesë për shkak të, “shkeljes ligjore rreth ngritjes së aktakuzës nga Prokuroria si dhe veprimeve të konfirmimit të aktakuzës nga Gjykata Themelore në Mitrovicë dhe Gjykatës së Apelit”.
19. Më 5 gusht 2021, Kryetari i Gjykatës Supreme përmes njoftimit (A. S. Su. A. 184/21) e informoi parashtruesin e kërkesës se rasti të cilin ai konteston është ende në pritje. Në një njoftim konkret, thekson kryetari i Gjykatës Supreme, “sipas Ligjit nr. 06/L-054 për Gjykatat, nen 26 të vendos: për ankesat në shkallë të tretë të lejuar me ligj; pastaj kërkesat për mjete të jashtëzakonshëm juridike kundër vendimeve të formës së prerë të gjykatave të Republikës së Kosovës edhe për çështjet administrative siç është paraparë me ligj, përcakton qëndrimet parimore në rast se kolegjet e kësaj gjykate kanë qëndrime të ndryshme për rastet e njëjtë; nxjerr mendime juridike dhe udhëzues për zbatimin unik të ligjeve nga gjykatat në territorin e Kosovës në situatë kur gjykatat e niveleve të ndryshme për çështje të njëjtë vendosin ndryshe. Në rastin e Juaj kjo gjykatë nuk ka çështje për vendosje, ndërsa për procedurat të cilat janë në zhvillim e sipër në Gjykata dhe Prokurori nuk merr qëndrime apo mendime juridike apo interpretimet ligjore ashtu siç kërkon”.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

20. Parashtruesi i kërkesës pretendon se njoftimin i kontestuar është nxjerrë me shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të parapara me nenet 3, 21, 23, 24, 27, 30, 31, 36, 37, nenin 38 dhe 40 të Kushtetutës.
21. Në lidhje me shkeljen e pretenduar të neneve të përmendura, parashtruesi i kërkesës arsyeton:

“NENI 3 [Barazia para Ligjit], këtu nuk jam duke u trajtuar i barabart para ligjit sepse prokurorja nuk më ka intervistuar asnjehere

Të Drejtat dhe Liritë Themelore Neni 21 [Parimet e Përgjithshme] Të drejtat e mijë janë shkelur prej momentit që më është montuar rasti nga policët dhe prokuroria e Mitrovicës për dhunë në familje pa pasur asnjë fakt, poashtu mohimi i përdorimit të mjeteve juridike siq është kërkesa për avokat ku jam dhunuar fizikisht, psiqikisht, nga policet se unë e kam kërkuar një të drejtë timen që ma garanton akti me i lartë i Shtetit Kushtetuta e Republikës së Kosovës!.

Neni 23 [Dinjiteti i Njeriut] Jam ofenduar, sharë, maltretuar vetëm pse kërkojsha të drejtën time për mbrojtje!

Neni 24 [Barazia para Ligjit] Diskriminimi në bazë të gjinise është duke ndodhur në rastin tim sepse këtu është duke i jep përparësi gjinisë tjetër pa pasur asnje fakt mbi akuzat që më ngarkohen!!

Neni 27 [Ndalimi i Torturës, Trajtimit Mizor, Çnjerëzor ose Poshtërues] Jamë torturuar poshtëruar nga policët në stacionin policor Mitrovicë vetëm pse kërkojsha të drejtën time të kem avokat mbrojtës!

Neni 29 [E Drejta e Lirisë dhe Sigurisë] Jam ndaluar pa asnje arsyje dhe ndalimi nuk më është sgruar dhe urdhër ndalimi ka ardh në gjuhen serbe që unë nuk e kuqtoj, ndalimi është bërë pas dhunës që është përdorur nga policia në stacionin policor!

Neni 30 [Të Drejtat e të Akuzuarit] Nuk më ehte ofruar asnje e drejtë minimale gjatë ndalimit, poashtu jam shtrënguar dhunuar nga policët që të bëjë deklaratë nën dhunë fizike psiqike, më janë ndaluar gjësendet e mijë personale siq ishin qelsat e veturës kur nuk ju kan jep familjareve të mi kur kan ardh me i marr dhe vutura më ka mbetur për dy ditë në parking Obiliq e hapur!

Neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] nuk mund të ketë gjykim të drejtë në atë vend ku është përdorur dhuna fizike ku edhe gjyqtari është caktuar në kundërshtim me ligjin sepse banon në të njëtin vend me ish bashkëshorten.

Neni 36 [E Drejta e Privatësisë] Mesazhet që i ka paraqitur prokurorja janë pranuar printuar në mënyrë të jashtëligjshme dhe kështu me është shkelur e drejta ime private e komunikimit me ish bashkëshorten!

Neni 37 [E Drejta e Martesës dhe Familjes] Aktakuza ndaj për Ngacmim me sms mendoj se është në kundërshtim me këtë nen të Kushtetutës dhe në kundërshtim me ligjin për familjen në Kosovë,

Neni 38 [Liria e Besimit, e Ndërgjegjes dhe e Fesë] më është mohuar e drejta e lirisë së besimit për sms që i kam shkruar bashkëshortes

Neni 40 [Liria e Shprehjes] Në komunikimin me sms aty tentohen nga prokuroria dhe gjykata të më mohohet liria e shprehjes”

22. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu pretendon shkelje të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, por nuk i specifikon nenet përkatëse.
23. Parashtruesi kërkon nga Gjykata që, “që kjo akuzë të shpallet e pavlefshme sepse akuza është ngritur nën dhunën fizike, psiqike, ofendimeve pa asnje arsyje të vetme“.
24. Në fund, parashtruesi kërkon nga Gjykata që të mos e zbulojë identitetin e tij publikisht.

Pranueshmëria e kërkesës

25. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuar me Kushtetutë, të parashikuar me Ligj dhe të specifikuara më tej me Rregullore të punës.

26. Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, që përcaktojnë:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngitura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

27. Gjykata gjithashtu i referohet kritereve të pranueshmërisë, siç përcaktohen më tej me Ligj. Në lidhje me këtë, Gjykata i referohet nenit 47 [Kërkesa individuale], i cili përcakton:

*Neni 47
[Kërkesa individuale]*

“Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

“Individ mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

28. Gjykata gjithashtu i referohet edhe rregullit 39 (1) (b) të Rregullores së punës, i cili përcakton që:

“(1) Gjykata mund ta konsiderojë një kërkesë të pranueshme nëse:

[...]

(b) janë shteruar të gjitha mjetet efektive të përcaktuara me Ligj kundër aktgjykimit ose vendimit të kontestuar.”

29. Gjykata do të shqyrtojë kushtetutshmërinë e vendimeve në lidhje me procedurën penale në gjykatat e rregullta kundër parashtruesit të kërkesës.

30. Gjykata fillmisht rikujton se rregulli për shterimin e mjeteve juridike sipas nenit 113.7 të Kushtetutës, nenit 47 të Ligjit dhe rregullit 39 (1) (b) të Rregullores së punës i obligon ata që dëshirojnë të paraqesin rastin e tyre në Gjykatën Kushtetuese që së pari duhet të shfrytëzojnë mjetet juridike efektive

në dispozicion në pajtim me ligjin, kundër një aktgjykimi ose vendimi të kontestuar.

31. Në këtë mënyrë, gjykata e rregullta u jepet mundësia që të korrigjojnë gabimet e tyre gjatë procedurës së rregullt gjyqësore para se çështja të vijë në Gjykatën Kushtetuese. Ky rregull bazohet në supozimin e shprehur në nenin 32 të Kushtetutës dhe nenin 13 të KEDNJ-së, që në legjislacionin vendës ka mjete juridike në dispozicion për t'u shfrytëzuar pranë gjykatave të rregullta në lidhje me shkeljen e pretenduara pavarësisht nëse dispozitat e KEDNJ-së janë inkorporuar në ligjin kombëtar apo jo (shih, *inter alia*, *Aksoy kundër Turqisë*, paragrafi 51, Aktgjykimi i GJEDNJ-së i 18 dhjetorit 1996).
32. Parimi është se mekanizmi mbrojtës, i krijuar nga Gjykata Kushtetuese të jetë subsidiar në raport me sistemin e rregullt gjyqësor që mbron të drejtat e njeriut (shih, ndër të tjera, *Handyside kundër Mbretërisë së Bashkuar*, paragrafi 48 i Aktgjykimit të GJEDNJ-së i 7 dhjetorit 1976)
33. Në bazë të nenit 113.7 të Kushtetutës, parashtruesi i kërkesës duhet të ketë një rrugë të rregullt deri te mjetet juridike të cilat janë në dispozicion dhe të mjaftueshme për të siguruar një mundësi për të korrigjuar shkeljet e pretenduara. Ekzistimi i mjetave juridike në fjalë duhet të jetë mjaft i sigurt jo vetëm në teori, por edhe në praktikë, dhe nëse nuk është kështu, atëherë këtyre mjetave juridike do t'iu mungojë disponueshmëria dhe efektiviteti i nevojshëm (shih, *inter alia*, *Vernillo kundër Francës*, paragrafi 27 i Aktgjykimit të GJEDNJ-së i 20 shkurtit 1991, dhe *Dalia kundër Francës*, paragrafi 38 i Aktgjykimit të GJEDNJ-së i 19 shkurtit 1998).
34. Gjykata duhet të shqyrtojë nëse janë shteruar mjetet juridike dhe nëse mjeti juridik ishte efektiv, në dispozicion në teori dhe praktikë në kohën përkatëse, përkatësisht, që ka qenë i qasshëm, që ka mundur t'i korrigjojë shkeljet në lidhje me kundërshtimet e parashtruesit të kërkesës, dhe gjithashtu ka ofruar një perspektivë të arsyeshme për sukses (shih, *inter alia*, *Civet kundër Francës*, paragrafët 42-44 të aktgjykimit të GJEDNJ-së, të 28 shtatorit 1999).
35. Megjithatë, kur një mjet juridik parashikohet me ligj, i takon parashtruesit të kërkesës të dëshmojë se mjeti juridik i paraparë me ligj është shteruar me të vërtetë ose për ndonjë arsyë nuk ka qenë në dispozicion dhe ka qenë joefektiv në rrethanat e posaçme të rastit, ose ka pasur rrethana të veçanta për shkak të të cilave ai ose ajo kanë qenë të liruar nga kushti i shterimit të mjetave juridike.
36. Duke iu rikthyer rastit konkret, del se, paralelisht me kërkesën e parashtruesit fillimisht në Gjykatën Supreme dhe më pas në Gjykatën Kushtetuese, në Gjykatën Themelore është duke u zhvilluar një procedurë gjyqësore, në të cilën ende nuk është nxjerrë një vendim meritor lidhur me aktakuzën me numër PP/II. nr. 1197/20 të ngritur kundër parashtruesit të kërkesës.
37. Në lidhje me këtë, Gjykata thekson faktin se të gjitha pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje ligjore dhe kushtetuese nga Prokuroria, Gjykata Themelore dhe Gjykata e Apelit lidhur me aktakuzën dhe kualifikimin e veprës penale, të cilat kanë të bëjnë me aktakuzën [PP/II. nr. 1197/20] të

parashtruar më 21 shtator 2020, mund të shqyrtohen gjatë procedurës së rregullt nga gjykatat e rregullta.

38. Prandaj, Gjykata konkludon se procedurat në gjykatat e rregullta lidhur me përgjegjësinë penale të parashtruesit të kërkesës janë ende në pritje në Gjykatën Themelore në bazë të aktakuzës së prokurorit të ngritur kundër parashtruesit të kërkesës, Gjykata gjen se parashtruesi e dorëzoi kërkesën e tij në Gjykatën Kushtetuese para shterimit të të gjitha mjeteve efektive juridike, përkatësisht se në legjislacionin e brendshëm ka mjete efektive juridike në dispozicion në gjykatat e rregullta në lidhje me shkeljen e pretenduar.
39. Andaj, lidhur me këtë, Gjykata bazuar në praktiken e saj gjyqësore thekson se nëse procedurat janë në zhvillim e sipër pranë gjykatave te rregullta, atëherë kërkesat e parashtruesve në Gjykatën Kushtetuese konsiderohen të parakohshme (shih, në këtë kontekst, rastet e Gjykatës, KI09/19, parashtrues *Leutrim Hajdari*, Aktvendim për papranueshmëri i 5 shkurtit 2019, paragrafi 41; KI23/10, parashtruese *Jovica Gadžić*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 19 shtatorit 2013, paragrafi 47; dhe KI102/16, parashtrues *Shefqet Berisha*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 2 marsit 2017, paragrafi 39).
40. Gjykata potencon se ky Aktvendim për papranueshmëri nuk e pengon parashtruesin e kërkesës që në të ardhmen, sërisht, të dorëzojë kërkesë kushtetuese brenda afatit ligjor 4 (katër) mujor nga dita që ka pranuar vendimin e fundit, nga gjykatat e rregullta. Ky vendim i Gjykatës konstaton që, tani për tani, kërkesa e parashtruesit është e parakohshme për arsyen legjislacioni në fuqi parasheh mjete efektive juridike përmes të cilave parashtruesi i kërkesës mund të kërkojë mbrojtjen e te drejtave të tij ligjore dhe kushtetuese.
41. Bazuar në sa më sipër, Gjykata konkludon se kërkesa e parashtruesit duhet të deklarohet e papranueshme, pasi që parashtruesi i kërkesës nuk ka shteruar mjetet e rregullta juridike në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenet 20 dhe 47 të Ligjit dhe rregullin 39 (1) (b) të Rregullores së punës.

Kërkesa për mos zbulim të identitetit

42. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës gjithashtu kërkon që identiteti i tij të mos zbulohet publikisht, duke mos përmendur arsyet konkrete për këtë.
43. Lidhur me këtë, Gjykata i referohet rregullit 32 (6) të Rregullores së punës, i cili parasheh „*Palët në kërkesë që nuk dëshirojnë që identiteti i tyre të zbulohet në publik, duhet të tregojnë arsyet që justifikojnë një largim të tillë ...*“
44. Megjithatë, Gjykata konstaton në kërkesë se parashtruesi nuk e arsyeton kërkesën e tij për moszbulim të identitetit dhe as nuk ofron apo dorëzon ndonjë provë në mbështetje të kërkesës së tij për moszbulim të identitetit.
45. Rrjedhimisht, kërkesa e parashtruesit për moszbulim të identitetit duhet të hidhet poshtë si e pabazuar.


PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenet 20 dhe 47 të Ligjit dhe rregullat 32 (6) dhe 39 (1) (b) të Rregullores së punës, më 10 nëntor 2021, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. TA REFUZOJË kërkesën për mosbulim të identitetit;
- III. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- IV. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- V. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues




Radomir Laban

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese



Gresa Caka-Nimani



Gresa Caka-Nimani